



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.535/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar , Beshir Islami dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit A. B. nga P., të cilin e përfaqëson Avokatja Liberta Bajrami nga P., kundër të paditurës K. Gj. e S., rruga P. – F., (M. P.), të cilën e përfaqëson avokati Leutrim Sylja nga P., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas revizionit të paditësit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5627/2021 datë 31.07.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 9.12.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pa themeltë revizioni i paditësit A. B. nga P., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5627/2021 datë 31.07.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5627/2021 dt.31.07.2024 është refuzuar si e pathemeltë ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2825/14 dt.17.05.2021, me të cilin, me pjesën e I të dispozitivit të tij, refuzohet kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia paguajë paditësit dëmin jo material në emër të dhimbjeve fizike të intensitetit të mesëm shumën prej 6,000.00 euro, në emër të dhimbjeve fizike të intensitetit të ulët shumën prej 4,000.00 euro, në emër të vuajtjeve

psikike të intensitetit të lartë shumë prej 4,000.00 euro, në emër të vuajtjeve psikike të intensitetit të mesëm shumë prej 3,000.00 euro, të intensitetit të ulët shumë prej 4,000.00 euro, në emër të dëmit material shumë prej 750,00 euro, të shkaktuar si pasojë e intervenimit kirurgjik laserik më datë 20.02.2010, në afat prej 15 ditësh nga marrja e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, si e pabazuar. Me pjesën e II të dispozitivit, detyrohet paditësi që të paguajë shpenzimet e të autorizuarit të paditurës për përfaqësim, në shumë prej 540.80 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, në afat ligjor paditësi ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim, siç thuhet në të, që ta anulojë dhe të ndryshojë aktgjykimin e atakuar të shkallës së dytë e po ashtu edhe aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e precizuar të palës paditëse apo çështjen ta kthejë në rivendosje.

Përgjigje në revizion ka paraqitur e paditura nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet e revizionit, me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të dispozitës së nenit 215 të LPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve të cekura në revizion, si dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

Revizioni i paditësit është i pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se pala paditëse më dt.22.10.2014, kundër të paditurës ka paraqitur padi, në gjykatën e shkallës së parë, për shkak të kompensimit të dëmit, me të dhënat si në petitumin e padisë dhe në precizimin e saj, përkatësisht, si në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së parë, nga administrimi i provave që gjenden në dosjen e kësaj lënde, ka vërtetuar se në mes të palëve nuk ka qenë kontestuese së më dt.20.02.2010, paditësi, tek e paditura, i është nënshtruar intervenimit kirurgjik në të dy sytë, kjo e vërtetuar edhe me raportin oftamologjik të dt.23.02.2010, lëshuar nga Klinika Gjermane e Syrit, me të cilin raport vërtetohet se paditësi më dt.20.02.2010, i është nënshtruar intervenimit kirurgjik në të dy sytë. Gjithashtu, nuk ka qenë kontestuese se paditësi Formularin Pëlqim për Pacientin lëshuar nga e paditura e ka nënshkruar personalisht më dt.20.02.2010, në të cilin formular në fund të tij është konstatuar se “ deklarojë që pasi më janë sqaruar natyra dhe lloji i operacionit, përkatësisht

intervenimi mjekësor dhe pasojat, përkatësisht komplikimet e mundshme që mund të rrjedhin, me vetëdije pranojë t'i nënshtrohem këtij intervenimi”, e që me anë të këtij formulari paditësi është pajtuar në të gjitha pikat e këtij formulari duke përfshirë edhe pikën gjashtë të tij në të cilën është përcaktuar se çmimi i kontraktuar vlen vetëm për një intervenim. Nga dokumenti i titulluar operacioni i lasik-ut, komplikimet që mund të rrjedhin nga lasik-u i lëshuar nga e paditura, e i cili dokument është nënshkruar nga paditësi vërtetohet se paditësi është njoftuar me komplikimet që mund të shfaqen pas operacionit. Në ekspertizën mjekësore të punuar nga eksperti Dr.Naser Salihu dt. 24.12.2019, është konstatuar se bazuar në dokumentacionin mjekësor si dhe ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, gjatë trajtimit për largimin e dioptrisë me metodën LASIK nuk janë vërejtur shkelje të procedurave apo mos respektim të protokolleve dhe standardeve të parapara për një intervenim të tillë gjatë përgatitjes pre operative, ashtu edhe gjatë ndërhyrjes kirurgjikale përfshirë këtu edhe tretmanin post operator.

Eksperti Dr. N. S., më tej, ka dhënë edhe sqarime shtesë, rreth çështjes së dioptrisë para intervenimit kirurgjikal në syrin e djathtë, dhe për syrin e majtë, rreth kësaj çështje pas intervenimit dhe gjatë ekzaminimit direkt të paditësit, për çka ka shpjeguar në seancën gjyqësore të dt.12.04.2021, kur, po ashtu gjatë seancës, eksperti ka sqaruar se nga shkresat e lëndës nuk ka vërejtur ndonjë lëshim eventual nga protokollat e aplikueshme për këtë lloj trajtimi, për këtë dhe çështje të tjera, në mënyrë më të detajuar, flitet në ekspertizën e ekspertit të lartë cekur dhe shpjegimet e tij të dhëna edhe në seancën gjyqësore të dt.12.04.2021.

Duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se pretendimet e paditësit në padi, për kompensim të dëmit janë të pabazuara sepse paditësi nuk ka provuar ekzistimin e përgjegjësisë së të paditurës për kompensimin e dëmit të kërkuar, nuk ka arritur të argumentojë në mënyrë konkrete, me asnjë provë të vlefshme, kërkesën e tij të pretenduar në kërkesëpadi, për kompensimin e dëmit përkatës. Prandaj, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe në bazë të dispozitave të nenit 154, nenit 158, nenit 35 etj, të LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën ankimore ka gjetur se janë të pathemelta pretendimet ankimore të paditësit dhe ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë duke vlerësuar se drejt ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të drejtë e ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar,

ndaj, e ka refuzuar ankesën e paditësit si dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë gjendje të çështjes, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët, janë marrë me zbatimin e drejtë të dispozitave të procedurës kontestimore dhe të së drejtës materiale, përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Aktgjykimi i goditur nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare.

Thëniet në revizion se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, kjo Gjykatë i vlerëson si të paqëndrueshme, ndërkohë që, nga gjykata e instancës më të ulët, janë dhënë arsyet e duhura për faktet relevante me rëndësi për vendosjen e drejtë të kësaj çështje juridiko-civile.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët përmbajnë arsye të plota dhe të mjaftueshme për të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, meqë të njëjtat gjykata drejtë kanë zbatuar të drejtën materiale dhe atë dispozitat përkatëse të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Kështu, edhe kjo Gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridiko-civil, nuk janë përmbushur në mënyrë kumulative të gjitha parakushtet e përgjegjësisë për kompensimin e dëmit të parapara me dispozitat e nenit 154, nenit 155 të LMD-së, siç janë; ekzistimi i subjekteve të marrëdhënies së detyrimeve dhe të përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, pra, shkaktuesin e dëmit dhe të dëmtuarin, ekzistimi i faktit dëmtues, nga rezulton dëmi, ekzistimi i dëmit të shkaktuar, ekzistimi i lidhjes shkakësore ndërmjet faktit dëmtues dhe dëmit të shkaktuar si dhe të ekzistojë kundërligjshmëria e veprimit, përkatësisht, e mosveprimit, gjë që, sikundër u theksua më lart, këto parakushte nuk janë provuar së ekzistuari nga pala paditëse. Nga këtu, Gjykata Supreme e Kosovës i vlerëson si të pa themelta thëniet e revizionit që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nga se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë vlerësuar dhe zbatuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmit është e pabazuar, se me provat e administruara nuk janë vërtetuar bindshëm faktet me të cilat do të vërtetohet baza e kërkesëpadisë për dëmin e kërkuar, nga se në këtë kontekst paditësi nuk ka ofruar prova relevante me të cilat do të vërtetonte bazën juridike dhe lartësinë e kërkesëpadisë, sikundër parashihet edhe me dispozitat e nenit 319, nenit 322 të LPK-së, ku veç tjerash, palët ndërgjyqëse kanë për detyrë të provojnë faktet mbi të cilat i

bazojnë kërkesat dhe pretendimet e veta. Gjykatat drejtë kanë vlerësuar se me provat e prezentuara nga paditësi dhe të administruara nga gjykata nuk janë vërtetuar bindshëm faktet përkitazi me themelësinë e kërkesëpadisë që kanë të bëjnë me ekzistimin e dëmit të kërkuar si dhe përgjegjësinë e të paditurës për kompensimin e atij dëmi.

Dhe kur jemi këtu, përkitazi me rastin konkret civil, në kontekstin e mësipërm, duhet theksuar, po ashtu se, nuk qëndron as pretendimi i revizionit lidhur me fletushkën “ jeta pa syze”, nga e cila pala paditëse pretendon se nuk është përmbushur premtimi i shënuar në të, nga se gjykata e instancës më të ulët, me të drejtë ka gjetur se kjo fletushkë siç është paraqitur para gjykatës nuk përbën ofertë për lidhjen e kontratës më pastaj, pasi që me nenin 35 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, përcaktohet se “ Dërgimi i katalogjeve, i listave të çmimeve, i tarifave dhe njoftimeve tjera, si dhe shpalljet e bëra me anë të shtypit, trakteve, radio, televizionit, ose në ndonjë mënyrë tjetër, nuk përbëjnë ofertë për lidhjen e kontratës, por vetëm thirrje që të bëhet oferta nën kondita të shpallura ”.

Sa i përket çështjeve tjera të revizionit, që kanë të bëjnë me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, (si në pikën II, f.2 të tij), duhet theksuar se sipas dispozitës së nenit 214.2 të LPK-së, “revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike ”.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.535/2024 datë 9.12.2024

SHËNIM PËR KËSHILLIM DHE VOTIM

Kryetar i kolegjit,
Mr.sc. Muhamet Rexha